



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.481/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit: “T...”-Dega në Kosovë, Rr.-Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompani D...C...A... shpk me adresë Rr. “...” nr.... -Prishtinë, kundër debitorit: N.T“ R,....” me numër të biznesit në cilësi e Kredi marrësit i përfaqësuar nga Sh.Z. dhe debitorit Sh.Z.1. me numër ID në cilësinë e bashkë kredi marrësit, që të dy me adresë banimi Rr.P/N-Prishtinë, që ka të bëjë me pagesën e kredisë, si objekt i përbarimit, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit të Përbaruesit Privat Gëzim Gjoshi P.nr.1033/2019 të dt:12.12.2019, mbi caktimin e përbarimit, me dt:26.08.2022, jashtë seance mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI I PABAZUAR prapësimi i debitorit: N.T “ R,....” me numër të biznesit në cilësinë e Kredi marrësit i përfaqësuar nga Sh.Z. dhe debitorit Sh.Z.1. me numër ID. në cilësinë e bashkë kredi marrësit, që të dy me adresë banimi Rr.P/N-Prishtinë, ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit numër P.nr.1033/2019 të dt:12.12.2019, i lejuar nga Përbaruesit Privat Gëzim Gjoshi.

A r s y e t i m

Zyra Përbarimore e përbaruesit privat në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përbarimor me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të marrëveshjes mbi kredinë nr.44713 datë 17.12.2014 dhe marrëveshjes mbi pengun nr.44713 datë 17.12.2014 (si shtojcë e marrëveshjes mbi kredinë) e regjistruar në Zyrën për regjistrimin e pengut R-... me datë 24.12.2019 deri me datë 24.12.2020, e cila marrëveshje mbi pengun paraqet titull ekzekutiv në bazë të nenit 21, 22 të LPP-së.

Kundër urdhrit përbarimor në afatin e paraparë ligjor prapësim ka ushtruar debitori i përbarimit me të cilin ka theksuar se të gjitha dokumentet që janë bashkangjitur urdhrit janë dokumente kopje ndërsa sipas Ligjit obligohen që dokumentet të jenë origjinale apo të vërtetuara tek noteri. Bazuar në nenin 36 të LPP-së së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohen edhe dokumentet përbaruese origjinale ose kopjet e vërtetuara së bashku me klauzolën e përbarushmeris.

Në përputhje me nenin 399 paragrafi 2 nen paragrafi 2.4 përbarimi është klasifikuar si proces juridik, vlefshmëria e të cilit është e lidhur dhe varur nga zbatimi strikt i formave (formularëve). Në përputhje me dispozitën e lartpërmendur, Ministria e Drejtësisë ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ MD - NR. 03/2015 për formën dhe mënyrat e urdhëresave, procesverbaleve dhe akteve tjera që përbaruesi privat i ndërmerr gjatë veprimeve formale përbaruese (i nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë me datën 05.02.2014) në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se cila është forma e Urdhrit për lejimin e përbarimit. Nga krahasimi i dokumenteve të lëndës dhe kërkesave ligjore qartazi mund të vërehet se nuk është respektuar forma e paraparë ligjore, rrjedhimisht nuk ka urdhër të vlefshëm, sepse nuk i është bashkangjitur Urdhri për lejimin e përbarimit - si akt juridik i veçantë ashtu siç është paraparë dhe përcaktuar me Ligj. Rrjedhimisht në përputhje me nenin 71 paragraf 1 nen paragrafi 1.2 - *ex lege* mund të konkludohet se "urdhri përbarues është pa efekt juridik" (në fakt nuk ekziston fare një i tillë). Ligji dhe Udhëzimi Administrativ nuk e njohin si urdhër përbarues në këtë formë të kreditorit - por vetëm urdhrin (aktin juridik) të përpiluar me të gjitha elementet - në përputhje me dispozitat ligjore të fuqi.

Debitori i përbarimit bazuar nga të cekuar me larte i ka propozuar Gjykatës që të aprovojë si të bazuar prapësimin e debitorëve të ushtruar kundër urdhrit për përbarim.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të pa qëndrueshme pasi që debitori pretendon se ka shkelje procedurale dhe urdhri përbarimor, nuk ka titull ekzekutiv siç është marrëveshja e pengut, po ashtu debitori pretendon se dokumentacioni nuk është origjinal, ndërsa i gjithë dokumentacioni është i vulosur nga DCA Sh.p.k, përfaqësues i bankës T... me autorizim, prandaj duke u bazuar në këto që u parashtruan dhe në bazë të urdhrit përbarimor i ka propozuar gjykatës që të hedh poshtë të pa bazuar prapësimin e ushtruar nga ana e debitorit dhe të konstatohet si i bazuar Urdhri Përbarimor dhe të bllokohen të gjitha llogaritë bankare të debitorëve.

Gjykata ka vlerësuar dokumentet përbarimore: marrëveshjes mbi kredinë nr.44713 datë 17.12.2014 dhe marrëveshjes mbi pengun nr.44713 datë 17.12.2014 (si shtojcë e marrëveshjes mbi kredinë) e regjistruar në Zyrën për regjistrimin e pengut R-.... me datë 24.12.2019 deri me datë 24.12.2020, e cila marrëveshje mbi pengun paraqet titull ekzekutiv në bazë të nenit 21,22 të LPP-së konkretisht neni 5 par.2 pika 1.7a të Ligji Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/l-139 për Procedurën Përbarimore, në bazë të të cilit përbaruesi privat ka zbatuar përbarimin, i cili dokument përbarues përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 27 i LPP-së, për të qenë të përbarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përbarim.

Gjykata, bëri shikimin e shkresave të lëndës, analizoi pretendimet e debitorit në prapësim, dhe vlerësoi se janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par 4 të LPP-së, se nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përbaruesit Privat

apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe të njëjtin e refuzoj.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.481/22, dt.26.08.2022

G j y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Dhomat e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.